



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 34, datë 02.04.2024

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “RESORT TURISTIK, REZIDENCIAL, HOTELERI DHE SHËRBIME ME 1, 2, 3, 4 DHE 5 KATE MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË, ZONA A (OBJEKTI 1 DHE 2), ZONA B (OBJEKTI 3), ZONA C (OBJEKTI 4 DHE 5), ZONA E (OBJEKTI 6), ME VENDNDODHJE NË POTAM, BASHKIA HIMARË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Bega-07” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Resort turistik, rezidencial, hoteleri dhe shërbime me 1,2,3,4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, Zona A (objekti 1 dhe 2), Zona B (objekti 3), Zona C (objekti 4 dhe 5), Zona E (objekti 6), me vendndodhje në Potam, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Bega-07” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

**KRYETARI**


**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 13/03 2025